



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)

[Data] 18.06.2024

Drejtuar: **“Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L**

Adresa: Rruga Ish Blloku i Magazinave te Tregtise, Rruga Siri Kodra TIRANE

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra” – “Marrëveshje kuadër”

Numri i procedurës: **REF-91142-12-15-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”**, me fond limit 1,484,255 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.:

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike- Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “F.L.E.SH.” sh.p.k., me NIPT J91801004M, me ofertë ekonomike 940,725 [nëntëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë] lekë pa TVSH.
2. “FILARA” sh.p.k., me NIPT K51611059N, me ofertë ekonomike 1,325,377 [një milion e treqind e njëzetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë] lekë pa TVSH.
3. “Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L, me ofertë ekonomike 1,061,974 [një milion e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër] lekë pa TVSH.

4. “KRISTALINA.KH” sh.p.k., me NIPT K11501002D, me ofertë ekonomike 1,410,720 [një milion e katërqind e dhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë] lekë pa TVSH.
5. “ONUFRI” sh.p.k., me NIPT J91801003E, me ofertë ekonomike 836,200 [tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind] lekë pa TVSH.

Vlera e pritshme e kontratatës është 1,061,974 [një milion e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër] lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

“ONUFRI” sh.p.k., me NIPT J91801003E, me ofertë ekonomike 836,200 [tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind] lekë pa TVSH.

Për arsye se ofertat e operatorit ekonomik “ONUFRI” sh.p.k dhe “F.L.E.SH” dolën anomalisht të ulëta, ju kërkuan sqarime. Pas paraqitjes së sqarimeve u mbajt procesverbali nr. 3625/15 prot., datë 15.01.2024, ku pasi u pritën afatet e përcaktuara sipas nenin 93 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, rezulton se Operatori ekonomik “ONUFRI” sh.p.k, nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me argumentimin e ofertës animalisht të ulët dhe për këtë arsye nuk kualifikohet.

“F.L.E.SH.” sh.p.k., me NIPT J91801004M, me ofertë ekonomike 940,725 [nëntëqind e dyzetë e një mijë e shtatëqind e njëzet e pesë] lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr 154/13 prot., datë 26.04.2024 e shtjelluar si më poshtë vijon duke arsyetuar pretendimin e pranuar nga ankesa e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit që përmban ky dokumentacion rezulton, se nga ana e operatorit ekonomik “FLESH” SHPK është paraqitur tabela me emërtimin “kosto analitike për prodhimin e diplomave”, e cila përmban analizën e kostos për letër për prodhimin e diplomave vertikal me përmasa të letrës (axb) 22.4 x 33.3 cm 300gr/m2, letër për prodhimin e diplomave horizontal me përmasa të letrës (axb) 22.4x33.3 cm 300 gr/m2 super fine, klishe për formatin vertikal shtyp i nxehtë dhe kuposje, klishe për formatin horizontal shtyp i nxehtë dhe kuposje, lastra për dy variantet, bojë shtypi për prodhimin e diplomave si dhe numratorin me ngjyrë të kuqe, bojë e padukshme me sy të lirë për logon UMT, varak gold shtyp të nxehtë me bobina 70 cm lineare, varak silver, për shtyp të nxehtë me bobina 70 cm lineare, varak i kuq për shtyp të nxehtë me bobina 70cm lineare, varak zi për shtyp të nxehtë me bobina 70 cm linere, hologram, bojë printeri, orë pune (shtyp, offsett, shtyp i lartë numrator, shtyp i nxehtë varak, hologram, kuposje, prerje, paketim), orë pune printim digital, transport dhe lëvizje për shërbim të prodhimit të diplomave, shpenzime të domosdoshme për konsum të ulët, detyrime tatimore, paga për kohën përkatëse të prodhimit të diplomave, energji elektrike dhe ujë bazuar në konsumin mesatar të tre muajve. mban datën 05.01.2024, ndërkohë procedura e prokurimit dhe dorëzimi i ofertës ekonomike është kryer në datë 28.12.2023.

Në këto kushte Komisioni gjykon, se referuar preventivit të zërave të ofruar, sipas parashikimeve në dokumentet e tenderit për zërat e sipërcituar nuk është paraqitur analizë kosto e detajuar duke justifikuar listën e çmimeve të ofruara në ofertën ekonomike, pasi dokumentacioni

provues referuar materialeve të sipërpërmendura mban datën 05.01.2024 pas zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, operatori ekonomik “FLESH” SHPK, nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, nuk ka arritur të argumentojë elementet e ofertës së tij për të cilët autoriteti kontraktor ka kërkuar shpjegime, siç parashikohet në nenin 93 të LPP-së si më sipër cituar, duke mos krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Për arsyen e sipërcituar Operatori Ekonomik “F.L.E.SH.” sh.p.k., me NIPT J91801004M nuk kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit:

“Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L me adresë TIRANE, “Rruga Ish Blloku i Magazinave te Tregtise, Rruga Siri Kodra TIRANE ” me ofertë ekonomike 1,061,974 [një milion e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër] lekë pa TVSH është identifikuar si fitues paraparak i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlind BROCI